Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	**15.08.2023**	**25.08.2023**	**2023/0565**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.08.2023, OE "ALFA.i"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0565, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "" CTA " Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq" me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, , vlera e parashikuar e kontratës: 590,870.72 €. më Nr. 2023/0565 i dt:10.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 26 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 8 i Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim publik

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 09.06.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 14.07.2023, ku kanë qenë 3 ofertues. Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt.26.07.2023 ku është rekomanduar për kontratë OE CTA Sh.p.k me çmim prej: 461.396.18 € për Lot 1.

Ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

"O.E: ALFA.i. Gjate vlerësimit te ofertës se juaj nga komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk i përmbushni kriteret e kërkuara ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftim për Kontratë, pasi qe te kushtet e përgjithshme te D.T është kërkuar qe stafi professional te jen te certifikuar me certifikatë profesionale niveli IV (Instalim, ngrohje , kanalizim dhe ujesjelles), ndërsa juve ju mungon Certifikata Profesionale e stafit teknik si dhe ju mungon diplomat te noterizuar për pjesën e stafit teknik, Po ashtu te stafi profesional te Inxhinierëve mungon Certifikata për mbrojtje nga zjarri Si dhe te ju ne ofertën e juaj nuk keni plotësuar Aneksi - 7 te vendosur nga A.K ne D.T ku është kërkuar te plotësohet dhe te nënshkruhet nga O.E për AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE, ka qen kusht administrative pasi qe është ANEKS i veçantë qe duhet plotësuar, andaj me këtë ju njoftojmë qe oferta juaj është e pa përgjegjshme dhe eliminoheni nga ky A.P

Ju sqarojmë se asnjëra nga arsyet e eliminimit nuk qëndron, sepse ne i kemi i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e DT!

Sa i përket certifikatave profesionale, ju informojmë se ne kemi dorëzuar Certifikata Profesionale të stafit teknik te noterizuara sipas kërkesës se DT dhe arsyeja e eliminimit nuk ka bazë faktike e as ligjore (shih te bashkangjitur dok.)

Sa i përket inxhinierit z. Safet Maxharraj ne kemi ofruar Certifikata për mbrojtje nga zjarri dhe kjo mund të vërtetohet tek Folderi me Nr.7 Lista e stafit profesional. Kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të analizohen në detaje i tërë dokumentacioni që ne e kemi ofruar me rastin e ofertimit dhe të konstatohet saktë gjendja faktike, (shih te bashkangjitur dok.)

Po ashtu ju sqarojmë se ne kemi dorëzuar një deklarate te veçantë për sa i përket garancionit te produkteve dhe kemi dorëzuar Planin dinamik sa i përket kërkesës për implementimin e projektit. Gjithashtu këto të dhëna i kemi vendosur edhe ne formularin e dorëzimit i cili gjenerohet nga sistemi, prandaj ky arsyetim i AK nuk qëndron. (shih te bashkangjitur dok.)

Ne jemi të habitur me vlerësimin e autoritetit kontraktues, ku është bërë një vlerësim subjektiv dhe i njëanshëm.

Gjithashtu përmbajtja e aneksit 7 është përfshirë dhe është plotësuar në dëshmitë tjera, ku janë dhënë garancioni dhe periudha e implementimit, pra janë dhënë zotimet tona në lidhje me këto kërkesa. Çështja e aneksit 7 në raport me deklarimet dhe zotimet garantuese të dhëna me dëshmi tjera përbën devijim të vogël në harmoni me nenin 59.4 pika (ii), prandaj duhet trajtuar në këtë mënyrë ofertën tonë në raport me aneksin 7, e po ashtu edhe ofertën e secilit operator ekonomik duke përfshirë edhe të OE të rekomanduar për kontratë.

Ne kemi pasur qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

1. Mungon Marrëveshjet e noterizuara me inxhinieret e makinerisë.

Limited Liability Company alfa.i Construction · Engineering & Trade

4/8

2. Certifikata për mbrojtje nga zjarri për ing. Xhevat Berisha nuk është prezantuar sipas kërkesës, ku është kërkuar që e njëjta të jetë e noterizuar, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar të noterizuar, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

3. Për menaxherin z. Shaqir Elezaj Certifikata për Auditim te energjisë në ndërtesa është e pa noterizuar, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

4. Po ashtu edhe marrëveshjet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për stafin teknik nuk janë te noterizuara siç është specifikuar në dosje të tenderit, njëkohësisht edhe Certifikatat e tyre nuk janë të noterizuara. Andaj duke u bazuar në këtë fakt ky OE është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit pasi që nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

5. Një prej arsyeve për të cilat jemi eliminuar ne, është mos plotësimi i Aneks 7 (pjese e DT) - Deklarata për garancion dhe implementim te punimeve, **por te njëjtin Aneks** nuk e ka plotësuar as OE i rekomanduar për kontratë, por vetëm ka dërguar një deklaratë sipas formatit të tij ashtu siç edhe e kemi dorëzuar ne. Në këtë rast ka ndodh një favorizim i OE të rekomanduar për kontratë dhe trajtim jo i barabartë në raport me kompaninë tonë.

Gjithashtu ne besojme qe ne kerkesen e vendosur ne DT:

Kerkesa 2.
Per (LOT 1) Minimum 5 punonjës te trajnuar me certifikate profesionale niveli IV (instalim ngrohje,kanalizim dhe ujesjelles)

Kompania e shpallur "fituese" perben konflikt interesi me kushtin e vendosur ,pasi qe e njejta kompani familjarisht kane ne pronesi kompanine TERMO HIDRAULIKU e cila bene certifikimin e kerkuar per instalues niveli IV (relacioni ne mes te ketyre dy kompanive eshte se pronari i njere kompani eshte babai ndersa i tjetres eshte djali).

Duke pasur parasysh të gjitha mangësitë dhe të metat e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë rezulton se oferta e tij është e papërgjegjshme, ndërsa kur duhet të konsiderohet një ofertë e përgjegjshme e cek qartë neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku përcaktohet si në vijim:

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme në aspektin administrativ dhe teknik.

Dëshmitë e ofruara nga ky OE dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit.

Limited Liability Company
ALFA.i
Construction - Engineering & Trade

5/8

Rekomandimi për kontratë nuk është bërë në harmoni edhe me nenin 56 të LPP-së sepse nuk janë marr për bazë kriteret e përzgjedhjes ashtu siç parashihet në këtë dispozitë.

Ligjërisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka mundësi të shpërblehet me kontratë pasi që edhe neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e parasheh qartë se kur mund të konsiderohet i kualifikuar një Operator ekonomik.

Neni 25.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe

b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

Po ashtu dispozitat e mëposhtme të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik përcaktojnë si në vijim:

Neni 25.2 Kërkesat e pranueshmërisë, gjithnjë duhet të përmbushen nga OE.

25.5 Kriteret e përzgjedhjes:

a. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës

b. nuk mund të kenë peshë të caktuara;

c. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon

Niëra ose tietra

Kërkesat janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë,

ose

Kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë

Pra në bazë të dëshmive të cekura më lartë rezulton qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbush kërkesat minimale për kualifikim, prandaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Pra kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa të vlerësimit **Kalon/Nuk kalon**, ndërsa në këtë rast këto kërkesa nuk janë përmbushur nga OE i rekomanduar për kontratë dhe oferta e tij nuk duhet të kalojë më tutje.

Limited Liability Company
Construction - Engineering & T

6/8

Këtë fakt e qartëson edhe Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurim Publik ku në nenin 8.5 përcakton qartë:

8.5 Kriteret e përzgjedhjes:

i. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës

ii. nuk mund të kenë peshë të caktuara;

iii. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon

Në rastin konkret kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderi i OE të rekomanduar për kontratë është dashur të refuzohet menjëherë.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.04.08.2023, ndërsa ky vendim nuk është arsyetuar fare por vetëm janë përsëritur arsyet e eliminimit pa dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm.
Në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk është dhënë asnjë përgjigje në lidhje me pretendimet tona ankimore në raport me OE e rekomanduar për kontratë, prandaj ky fakt na jep të kuptojmë se të gjitha pretendimet tona në raport me OE e rekomanduar për kontratë janë të bazuara dhe të qëndrueshme dhe me këtë kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, kurse ne jemi ofertues i përgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 9 i LPP-së ku shkruan qartë "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".
Pra AK-së në këtë rast nuk ka bërë asnjë arsyetim në lidhje me vendimin e tyre për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, prandaj ky fakt përbë shkelje ligjore nga ana e AK-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm, sipas neni 60 paragrafi 1.2 i LPP-së.

Çmimi që ne kemi ofertuar është 428,520.85 € €, kurse OE i rekomanduar për kontratë është në vlerë prej 461.396.18 €, e që rezulton se diferenca e ofertimit është në vlerë prej: 32,875.33 €, e që është diferencë shumë e madhe.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së në mënyrë të drejtë, sepse nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me ofertën tonë është dashur të kërkojë sqarime shtesë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

alfa.i
Construction - Engineering & Trade

7/8

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", kurse OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pra është vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **ALFA i për LOT 1.**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

). Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

IV.2) KRITERET E DHENIES

Grupi 1. LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan,

Çmimi më i ulët: ☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të:** ☒

	Nënkriteret	Koeficient
1	Çmimi	
2	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese minimum 1 vite deri ne max 5 vite	
3	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës minimum 90 dite deri ne max 100 ditë	

Grupi 2. LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq,

Çmimi më i ulët: ☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të:** ☒

	Nënkriteret	Koeficient
1	Çmimi	
2	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese minimum 1 vite deri ne max 5 vite	
3	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës minimum 90 dite deri ne max 100 ditë	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	" CTA " Sh.p.k., 600028816	30000	Pjeter Bogdani Nr 24

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

OE CTA SHPK. është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit
përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me
461,396.18

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Pale me interes SIPAS NENIT 4.1.26 Të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ALFA.i**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: **"**Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq**", me numër të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës:590,870.72 €.**

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 09.06.2023,Ndërsa, me datë 15.06.2023 dhe 07.07.2023 ka publikuar B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve.
Me datë 26.07.2023 AK ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. OE ankues "ALFA.I SH.P.K" me datë 31.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kundër Vendimit të AK-së, ndërsa AK me datë 04.08.2023 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, OE ankues "ALFA.I SH.P.K" me datë 10.08.2023 , ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0565, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

Përgjigje Pretendimeve ankimore:

AK me datë 26.07.2023 përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Lertës standarde, ka njoftuar OE ankues për rezultatin e aktivitetit të prokurimit si dhe arsyet e elminimit të OE ankues "ALFA.I SH.P.K". Gjithashtu, edhe në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 04.08.2023, AK ka potencuar arsyet e njejta te eliminimit te OE ankues, e të cilat janë si në vijim:

"*Gjate vlersimit te ofertes se juaj nga komisioni i vlersimit ka konstatuar se nuk i permbushni kriteret e kerkuara ne Dosien e Tenderit dhe ne Njoftim per Kontrat, pasi qe te kushtet e pergjitheshme te D.T eshte kerkuar qe stafi professional te jen te certifikuar me certifikat profesionale niveli IV (Instalim, ngrohje , kanalizim dhe ujesjelles), ndersa juve ju mungon Certifikata Profesionale e stafit teknik si dhe ju mungon diplomat te noterizuar per pjesen e stafit teknik, Po ashtu te stafi profesional te Inxhinierave mungon Certifikata per mbrojtje nga zjari Si dhe te ju ne oferten e juaj nuk keni plotesuar Aneksi - 7 te vendosur nga A.K ne D.T ku eshte kerkuar te plotesohet dhe te nenshkruhet nga O.E per AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE, ka qen kusht administrative pasi qe eshte ANEKS i veqant qe duhet plotesuar, andaj me kete ju njoftojm qe oferta juaj eshte e pa pergjegeshme dhe eliminoheni nga ky A.P".*

Ndërsa, OE ankues pretendon se, " asnjera nga arsyet e eliminimit nuk qëndron, sepse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat **e DT!**

Sa i përket certifikatave profesionale, ju informojmë se ne kemi dorëzuar Certifikata Profesionale të stafit teknik te noterizuara sipas kërkesës se DT dhe arsyet e eliminimit nuk ka bazë faktike e as ligjore (shih te bashkangjitur dok.)"

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "ALFA.I SH.P.K", Eksperti shqyrtues sqaron se:

AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatesisht tek **Kërkesat mbi**

mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka përcaktuar si më poshtë:

"Kërkesa 2: Për (LOT-1), Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 10 punonjës. Minimum 5 punonjes të trajnuar me Certifikat profesionale niveli IV (Instali, Ngrohje,Kanalizim dhe ujsjelels)

Dëshmia e Kërkesës 2, Për (LOT-1) Lista e punëtoreve me kontrata apo para kontrata ne emer te projektin te jen te noterizuar ne prani ted y paleve minimum 10 punëtorë ,si dhe per 5 puntoret e trajnuar , certifikatat kopje te noterizuar".

Sipas kërkesën e lartcituar, AK në njoftimin mbi vendimin e AK-se me datë 26.07.2023, ka njoftuar OE-"ALFA.I SH.P.K", per eliminimin nga AP, me arsyetimin se, "*pasi qe te kushtet e pergjitheshme te D.T eshte kerkuar qe stafi professional te jen te certifikuar me certifikat profesionale niveli IV (Instalim, ngrohje , kanalizim dhe ujesjelles), ndersa juve ju mungon Certifikata Profesionale e stafit teknik si dhe ju mungon diplomat te noterizuar per pjesen e stafit teknik…",*

Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**, AK ka kërkuar ndër të tjera, - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 10 punonjës. Minimum 5 punonjes të trajnuar me Certifikat profesionale niveli IV (Instali, Ngrohje,Kanalizim dhe ujsjelels, ndërsa te Dëshmia e Kërkesës 2, Për (LOT-1) Lista e punëtoreve me kontrata apo para kontrata ne emer te projektin te jen te noterizuar ne prani ted y paleve minimum 10 punëtorë ,si dhe per 5 puntoret e trajnuar , certifikatat kopje te noterizuar.

Bazuar në kërkesën e lartë cekur, AK ka kërkuar "Certifikat profesionale niveli IV (Instalim, Ngrohje,Kanalizim dhe ujsjelles), duke mos specifikuar në kërkesën-dëshminë përkatëse se cilat konsiderohen të pranueshme (Certifikata si dëshmi të leshuara nga Institucionet Publike po Institucionet Private).

Pra, meqenëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, lidhur me këtë, OE ankues në Listen e Stafit, sipas kërkesës në dosjen e tenderit, ka prezantuar edhe 5 punëtor të angazhuar për këtë projekt me kontrata të noterizuara, për të cilët ka prezantuar Diploma të noterizuara të fushës përkatese (Instalim, Ngrohje,Kanalizim dhe ujsjelles). Si rrjedhojë, Diplomat dhe kontratat e prezantuara nga OE ankues lidhur me këtë kërkesë e përmbushin kërkesen e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Për faktin se, sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, "niveli IV" konsiderohet -Arsimi i mesëm i lartë.

Provë:

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4. Struktura e arsimit parauniversitar - nivelet formale dhe shkallët kryesore të kurrikulës

Roli i niveleve formale dhe shkallët kryesore të kurrikulës në organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë

Struktura e arsimit në Kosovë është në harmoni me Klasifikimin Standardit Ndërkombëtar të Arsimit si në tabelën e mëposhtme:

Nivelet sipas KSNA [1]		Nivelet Formale të Arsimit Parauniversitar në Kosovë[2]		Mosha
		Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)		23/24+
KSNA 6		Arsimi pasuniversitar		23/24+
KSNA 5		Arsimi universitar		
KSNA 4	Niveli 5 Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi passekondar jouniversitar		18 +
KSNA 3	Niveli 4 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi klasa X-XII Shkollat profesionale (klasat X-XII)	Matura	15-17
	Niveli 3 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Shkollat profesionale (klasat X-XI)		15-16 Shkollat profesionale
KSNA 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX		11-14
KSNA 1		Arsimi fillor Klasat I-V		6-10
KSNA 0		Klasa përgatitore		5-6
		Edukimi parashkollor		lindje-5

Nëpër nivele formale të arsimit, nxënësit në mënyrë koherente përgatiten për mësim gjatë tërë jetës dhe për botën e punës në epokën e dijes dhe të digjitalizimit.

Krahasuar me Kornizën e Kualifikimeve, korniza e kurrikulës u referohet vetëm 4 niveleve formale të arsimit dhe 5 niveleve të kualifikimeve. Me këtë ofrohet një bazë e mirë, një platformë e cila në të njëjtën kohë është dritare e hapur drejt arsimimit gjatë tërë jetës dhe arsimimit të të rriturve. Prandaj, në të gjitha shkallët dhe fushat e kurrikulës do të theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

[1] Klasifikimi Standardi Ndërkombëtar i Arsimit.
[2] Tri gjeneratë e fundit nuk janë gjenë të arsimit parauniversitar.

29

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues "ALFA.I SH.P.K", për arsyet e elmiminimit nga AK lidhur me Aneksi - 7 te vendosur nga A.K ne D.T ku eshte kerkuar te plotesohet dhe te nenshkruhet nga O.E per AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE.

Lidhur me këtë pretendim ankimor të OE ankues "ALFA.I SH.P.K", Eksperti shqyrtues sqaron se:

AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatesisht tek **Kërkesat mbi**

mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka përcaktuar si më poshtë:

"Kërkesa 10 Për (LOT-1), & (LOT-2) Operatori ekonomik duhet te paraqet një plan dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te

afatit te O.E

Dëshmia 10 Për (LOT-1), & (LOT-2) Planin dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te afatit te O.E".

Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**, AK ka kërkuar ndër të tjera "Për (LOT-1), & (LOT-2) Operatori ekonomik duhet te paraqet një plan dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te afatit te O.E, Dëshmia 10 Për (LOT-1), & (LOT-2) Planin dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te afatit te O.E".

Bazuar në kërkesën e lartë cekur, në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, AK nuk ka kërkuar ndonjë Formë Standarde se si duhet plotesuar Planin dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate. Andaj konsideroj se, AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE, dokumente të cilat janë prezantuar nga OE ankues, janë në pajtim me kërkesat e vendusura nga AK. Për faktin se, në kërkesën e lartë cekur si pikë referimi nuk përmendet aneksi 7. Për me tepër, Aneksi 7 nuk bënë pjesë të kriteret e përzgjedhjes.

Neni 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton citoj*: "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës.* ***Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.*** *Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. në rast se AK organizon vizite në vendpunishte apo konference para-ofertuese, pjesëmarrja e OE në vizite në vend-punishte/konference para-ofertuese nuk duhet të jete obligative. Vizita në vend-punishte/konference para-ofertuese organizohet për OE dhe është në të mirën e tyre, pra është ndihmese për OE".*

Sipas dispozitës së lartëcituar, Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Gjithashtu AK, në njoftimin mbi vendimin e AK-se me datë 26.07.2023, ka njoftuar OE-"ALFA.I SH.P.K", per eliminimin nga AP, me arsyetimin se *"ju mungon Certifikata Profesionale e stafit teknik si dhe ju mungon diplomat te noterizuar per pjesen e stafit teknik, Po ashtu te stafi profesional te Inxhinierave mungon Certifikata per mbrojtje nga zjari…"*

Për këtë pretendim ankimor të OE ankues "ALFA.I SH.P.K", Eksperti shqyrtues sqaron se:

Sipas nenit 59 të LPP-se, autoriteti kontraktues do ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Kjo do të thotë se AK gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, përcakton përgjegjshmërinë e tenderëve vetëm në bazë të kërkesave që i ka specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ndërsa sa i përket mos ofrimit të ndonjë dokumenti nga ana e Operatorit Ekonomik e që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-së.

"Lista e Punëtorëve" përmendet si dëshmi në nenin 69 të LPP-së, në rastin konkret janë kërkuar edhe dëshmi Certifikatat përkatëse si dhe Diploma të noterizuara, prandaj sa i përket dëshmive te kërkuara ne DT, konsideroj se, AK gjatë vlerësimit të tenderëve, për mungesa informacionesh apo gabime eventuale mund të kërkohen sqarime shtesë në përputhje me nenin 72 të LPP-së.

Lidhur me sqarimet e tenderit, paragrafi 1 i nenit 72 të LPP-së përcakton:

*"Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duket të jetë **jo i plotë** ose **i gabuar,** ose kur **mungojnë dokumentet specifike,** autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik qe **të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë** informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".*

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në **pajtim me nenet 65-71** të këtij ligji. **Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.**

Gjithashtu, për të ndihmuar AK-në në vlerësimin e tenderëve, Udhëzuesi për Prokurim Publik, parasheh një tabelë me disa shembuj, të cilën janë paraqitë disa nga problemet që mund të hasin AK-të gjatë vlerësimit të tenderëve dhe zgjidhja se si të veprohet. *Shembujt e paraqitura në këtë tabelë nuk janë te vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-së.*

Bazuar në dispozita e lartcekura, për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm tenderi në fjalë duhet të jetë në pajtim me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Në rast se gjatë procesit të vlerësimit, AK konstaton se OE nuk ka ofruar ndonjë dëshmi në pajtim me atë që është kërkuar në dokumentet e tenderimit, ka të drejtë që në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të

LPP-së të kërkojë sqarime me shkrim nga OE.

Ndërsa, sa i perket pretendimeve ankimore të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë, ku thuhet se: "eshte I papergjegjeshm" per arsyet si ne vijim:

"1. Mungon marreveshjet e noterizuara me inzhinier te makinerise,

2. Certefikata per mbrojtjen nga zjarri per ing Xhevat Berisha nuk eshte prezantuar sipas kerkeses ku eshte kerkuar e njejta te jete e noterizuar, mirepo OE I rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar te noterizuar, prandaj ky OE eshte i papergjegjshem.

3. Per menaxherin z. Shaqir Elezaj Certifikata per Auditim te energjise ne ndertesa eshte e pa noterizuar, prandaj ky OE eshte i papergjegjshem.

4. Po ashtu edhe marreveshjet e prezantuara nga OE I rekomanduar per kontrate per stafin teknik nuk jane te noterizuara sic eshte specifikuar ne dosjen e tenderit , njekohesisht edhe Certifikatat e tyre nuk jane te noterizuara . Andaj duke u bazuar ne kete fakt ky OE eshte dashur te eliminohet nga aktiviteti I prokujrimit pasi qe nuk ofertuar konform kerkesave te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontarte.

5. Nje prej arsyeve per te cilat jemi eliminuar ne, eshte mos plotesimi I Aneksit 7 (pjese e DT)- Deklarata per garancionin dhe implementimin e puneve, **por te njejtin aneks** nuk e ka plotesuar as OE I rekomanduar per kontrate, por vetem ka derguar nje deklarate sipas formatit te tij ashtu sic edhe e kemi dorezuar ne. Ne kete rast ka ndodh nje favorizim I OE te rekomanduar per kontrate dhe trajtim jo I barabarte ne raport me kompanine tone".

Eksperti Shqyrtuese I ka shqyrtuar këto pretendim ankimore, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit përkatësisht pretendimit të OE ankues, gjithashtu ofertës së OE të rekomanruar për kontratë, lidhur me këto pretendim ankimore te OE ankues, Eksperti shqyrtue sqaron se: Sa I perket pikes 1,2,3 dhe 4 jane evidente mangesite ne deshmite respektive te kerkuara nga AK sipas kerkeses se dosjes se tenderit dhe njoftim per kontrate, si rrjedhoje nga OE I rekomanduar nuk jane dorezuar te noterizuara sipas kerkeses ne fjale.

Ndarsa, sa i perket pikes 5, ku thuhet se "nje prej arsyeve per te cilat jemi eliminuar ne, eshte mos plotesimi I Aneksit 7 (pjese e DT)- Deklarata per garancionin dhe implementimin e puneve, **por te njejtin aneks** nuk e ka plotesuar as OE I rekomanduar per kontrate", lidhur me kete, eshte evidente qe edhe ne rastin konkret nuk eshte plotesuar Aneksi 7, gje qe njera nga arsyet e eliminimit te OE ankues ka te beje edhe me mos plotesimin e Aneksit 7, megjithate, sa I perket Aneksin 7 kemi dhene sqarime ne fillim.

Gjithashtu,

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, "se ne vendimin per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim me date 04.08.2023, nuk eshte arsyetuar fare, por vetem jane perserit arsyet e eliminimit pa dhene shpjegime te hollesishme…".

Eksperti shqyrtues sqaron se, AK me datë 26.07.2023 përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Lertës standarde, ka njoftuar OE ankues për rezultatin e aktivitetit të prokurimit si dhe arsyet e elminimit të OE ankues "ALFA.I SH.P.K". Gjithashtu, edhe në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 04.08.2023, AK ka potencuar arsyet e njejta te eliminimit te OE

ankues, pa dhene sqarime konkrete ne pretendimet ankimore.

Sipas paragrafit 9 te nenit 108/A te LPP-se, percaktohet qartë se, "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Gjithashtu kurdo qe refuzohet nje kerkese per rishqyrtim, edhe neni 62.2 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton:

"**62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.**

Sa I perket pretendimit ankimor te OE ankues, ndaj OE te reakomanduar per kontrate, "se kompania "Fituese" perben konflikt interesi me kushtin e vendosur, pasi qe e njejta kompani familjarisht kane ne pronesi kompanin TERMO HIDRAULIKU e cila bene certifikimin e kerkuar per instalues niveli IV (relacioni ne mes ketyre dy kompanive eshte se pronari I njere kompani eshte babai ndersa I tjetres eshte djali)".

Eksperti Shqyrtuese lidhur me këtë pretendim ankimor, konsideron se, verifikimi për Konflikt të Interesit është përtej mundësive dhe kapaciteteve të ekspertit shqyrtues. Megjithatë, kurdo që OE ka dyshime lidhur me këtë çështje, për ta qartesuar kete situate, mund ti drejtohet organeve kompetente.

Gjithashtu, AK gjatë fazes se vleresimit te tendereve, sipas paragrafit 7 të nenit 52 të LPP-së, "*Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit*".

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK ne kete aktivitet te prokujrimit nuk ka respektuar nenin 72 te LPP-se gjithashtu nuk eshte respektuar neni 7 I LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se, duke u bazuar ne sqarimet e lertepermendura, analizen e fakteve dhe dëshmive te dokumentuara ne platformen elektronike e-prokurim, rrjedhen e procedures se prokurimit, lidhur me kete aktivitet te prokurimit, AK-Komisioni i Vleresimit, **nuk ka respektuar ne teresi nenin 7,59,69,72,108/A të LPP-së**, **si dhe nenin 10** të **Udhëzuesit për Prokurim Publik,**sepse eshte pergjegjesi dhe ne diskrecionin e Autoritetit Kontraktues respektivisht Komisionit Vleresues, qe procesi i vleresimit , ekzaminimit dhe krahasimit te tendereve te behet ne pajtim me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytesor per prokurimi publik, ne menyre qe te respektohen kerkesat e vendosura nga AK ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim per kontrate.

Sipas paragrafi 4 të nenit 59 të LPP, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve, i cili përcakton:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të

cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Pra, gjatë procesit të vlerësimit te tendereve, me qellim qe vleresimi i tendereve te behet ne harmoni me ligjin dhe legjislacionin per prokurimi publik, gjithashtu ne menyre qe te trajtohen te barabarte te gjithe OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit, AK ne rast se konstaton se Operatoret Ekonomik nuk kane ofruar ndonjë dëshmi në përputhshmëri me atë që është kërkuar në dokumentet e tenderimit, ka të drejtë që në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së të kërkojë sqarime me shkrim nga OE, dhe në rast se dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar ka të drejtë sipas paragrafit 7 të nenit 52 të LPP-së të kryej një kontroll efektiv të dokumentacionit të tenderit.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, duke u bazuar në pretendimet ankimore të OE ankues, gjithashtu duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, i propozon Autoriteti Kontraktues AK-Komuna Pejës, të Anuloi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, si dhe Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi Tenderëve të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit per prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ALFA.i**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

ismail rushiti